



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2114/ 10 prot.

Datë 22/10/2025

V E N D I M
Nr. 1519/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22/10/2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 1335/2025, datë 25.09.2025 për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I “Pajisje për zyrat” me fond limit: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Muça” SHPK me NIPT K01421002H, me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, km 13, Picar, Vorë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Tiranë.
Adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “M Lezha” SHPK me NIPT J76504013C, me adresë: Rruga “Lëvizja e Postribës”, Nr. Pasurisë 11/200, Zona Kadastrale 8592, Zona Industriale, Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për

miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 25.09.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1335/2025, ku vendosi:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Muça” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I “Pajisje për zyrat” me fond limit: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Muça” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Muça” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën nr. 36113 prot., datë 17.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2114/7 prot., datë 20.10.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1335/2025, datë 25.09.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I “Pajisje për zyrat” me fond limit: 15,408,601 (pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë

mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 36113 prot., datë 17.10.2025, protokolluar me tonën nr. 2114/7 prot., datë 20.10.2025, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1335/2025, datë 25.09.2025, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit *“Proçedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”* me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I *“Pajisje për zyrat”* me fond limit: 15,408,601 *(pesëmbëdhjetë milion e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.*

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1335/2025 datë 25.09.2025, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlersimin e procedurës duke rishikuar statusin operatorit ekonomik *“Muça”* SHPK ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1335/2025, datë 25.09.2025 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

Përsa më sipër, në mbështetje të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit *“Proçedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar”* me Nr. REF-48707-05-22-2025, me objekt Loti I *“Pajisje për zyrat”* me fond limit: 15,408,601 *(pesëmbëdhjetë*

million e katërqind e tetë mijë e gjashtëqind e një) lekë pa TVSH ose 157,054.33 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëdhjetë e katër pikë tridhjetë e tre) euro pa TVSH, parashikuar për t'u zhvilluar më datë 23.06.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Tiranë.

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

